



MBAHET SAMITI I LIDERËVE EVROPIANË NË KRYEQYTETIN E SHQIPËRISË

EVROPA BASHKOHET NË SHQIPËRI, LIDERËT DISKUTOJNË PËR SFIDAT E SIGURISË DHE TË MBROJTJES



Shqipëria, e drejtuar nga kryeministri Edi Rama, ka qenë nikoqire e samitit njëditor në të cilin kanë marrë pjesë liderët e shteteve evropiane. Në këtë samit është diskutuar për sfidat

e sigurisë dhe të mbrojtjes. Në epiqendër ka qenë lufta në Ukrainë. Po në këtë samit është diskutuar edhe për procesin e integritetit në BE dhe për emigracionin. Kosova në këtë

samit është përfaqësuar nga presidentja Osmani, e cila ka kërkuar nga BE-ja t'i heqë masat ndëshkuese ndaj Kosovës para vazhdimit të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve

MUSLIU-SHOSHI:
RRUGA EVROPIANE E KOSOVËS KA STAGNUAR, HUMBËM RASTIN PËR ANËTARËSIM NË KËSHILLIN E EVROPËS F.5




ÇFARË PËRFITON KOSOVA NGA CISMOA, PAKTI QË LIDHI ME SHBA-në? F.7



PARAQITET PROJEKTI "SOLAR 4KOSOVO II", INVESTIM MBI 80 MILIONË EURO PËR ENERGJI TË GJELBËR NË PRISHTINË F.8

BAJRAMI PUBLIKON TË DHËNAT E ASK-SË: NË QEVERINË KURTI KA LULËZUAR IMPORTI I ENERGJISË ELEKTRIKE F.8

SPORT



TË DIELËN ZHVILLOHET FINALJA E PESTË F.10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030-500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Gjykata Supreme mund ta bllokojë urdhrin e Trumpit për shtetësinë

WASHINGTON, 16 MAJ - Gjykata Supreme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) të enjten u duk e vendosur për t'i ndaluar kufizimet e presidentit Donald Trump për shtetësinë automatike për fëmijët e lindur në ShBA, dhe për të gjetur një mënyrë për t'i kufizuar urdhrat e gjykatave më të ulëta të shteteve amerikane.

Nuk u bë e qartë se si mund të duket një vendim i tillë, por një shumicë gjyqtarësh shprehu shqetësime për atë që do të mund të ndodhte nëse administrata Trump do të lejohej, qoftë edhe përkohësisht, t'ua mohonte shtetësinë fëmijëve të lindur nga njerëzit që ndodhen ilegalisht në Shtetet e Bashkuara, raporton "Associated Press".

Gjyqtarët kanë dëgjuar argumentet e apeleve urgjente të

administratës Trump ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, të cilat i kanë pezulluar kufizimet për shtetësinë në shtetet amerikane.

Masat për pezullim janë paraqitur si një ndalesë kritike ndaj përpjekjeve të Trumpit për reforma qeveritare, dhe si një burim i zemërimit në rritje për presidentin republikan dhe për aleatët e tij. Gjyqtarët kanë lëshuar 40 masa kufizuese që kur Trumpi ka nisur mandatin e tij të dytë presidencial, në janar, i tha gjykatës avokati i Shtetit, John Sauer, në fillim të argumentimeve që zgjatën mbi dy orë.

E drejta e shtetësisë automatike të fituar me lindje është në mesin e disa çështjeve, shumica prej tyre të lidhura me migracionin, që administrata i ka kërkuar gjykatës ta shqyrtojë në mënyrë



urgjente. Gjyqtarët janë duke shqyrtuar edhe kërkesat e administratës Trump për t'i dhënë fund lejeve humanitare për më shumë se 500.000 njerëzve nga Kuba, Haiti, Nikaragua dhe Venezuela, dhe për t'i hequr mbrojtjet e tjera të përkohshme ligjore për 350.000 venezuelas të tjerë.

Administrata mbetet e përfshirë në betejat ligjore për përpjekjet e saj për dëbimin e shpejtë të njerëzve të akuzuar për përfshirje në banda drejt një

burgu në El Salvador, sipas një ligji të kohës së luftës nga shekulli i 18-të.

Trumpi ka nënshkruar një urdhrë ekzekutiv, në ditën e parë të mandatit të tij të dytë, i cili do t'ua mohonte shtetësinë automatike fëmijëve të lindur në ShBA nga njerëz që ndodhen në vend ilegalisht apo përkohësisht. Urdhri bie ndesh me një vendim të Gjykatës Supreme të vitit 1898, i cili vlerësonte se neni për shtetësinë i Amendamentit të 14-të të Kushtetutës së ShBA-së i bënte shtetas të gjithë fëmijët e lindur në tokën amerikane, me përjashtime të caktuara që nuk vijnë në shprehje në këtë rast. Shtete amerikane, imigrantë dhe grupe për të drejta të njeriut kundërshtuan menjëherë urdhrin në gjyq, ndërsa gjykatat më të ulëta e ndaluan shpejt zbatimin e tij deri në shqyrtimin

e rasteve. Gjyqtarët liberalë të Gjykatës Supreme u dukën të vendosur për të mbështetur vendimet e gjykatave më të ulëta, të cilat vlerësuan se ndryshimet ndaj shtetësisë të cilat Trumpi dëshiron t'i bëjë do ta ndryshonin kuptimin e të drejtës automatike për shtetësi prej më shumë se 125 vjetësh.

Nëse qeveria fiton rastin, ajo mund ta zbatojë urdhrin ndaj njerëzve që nuk e kanë kundërshtuar atë në gjyq, tha gjyqtarja Elena Kagan.

"Ata që nuk mund ta përballojnë gjyqin, do të humbin", ka thënë ajo. Gjyqtarja Ketanji Brown Jackson, ka përshkruar qasjen e administratës si "më kap nëse mundesh", që e detyron këto të ngre padi për të ndaluar "shkeljen e të drejtave të njerëzve nga qeveria". Vendimi i gjykatës pritet deri në fund të qershorit.

Firma e sanksionuar serbe eksportoi pjesë avionësh në Rusi, përfshirë edhe nga ShBA-ja

BEOGRAD, 16 MAJ - Kompania serbe Sprocure, e cila është përfshirë më 14 maj në paketën e 17 të sanksioneve të Bashkimit Evropian (BE) ndaj Rusisë, ka transportuar në Rusi 170 dërgesa brenda një viti e gjysmë.

Hulumtimi i Radios Evropa e Lirë (REL) mbi të dhënat doganore tregon se vlera e këtyre dërgesave nga mesi i vitit 2022 deri në fund të vitit 2023 ka kaluar shumë prej 9.7 milionë dollarësh.

Sipas bazës së të dhënave Import Genius, në Rusi kanë përfunduar pjesë për avionë që ndodhen nën regjim të veçantë sanksionesh që nga fillimi i agresionit rus ndaj Ukrainës, në shkurtin e vitit 2022.

Paketa e re e sanksioneve ndaj Rusisë, e cila pritet të miratohet më 20 maj, përfshin edhe kompani nga vendet e treta që ndihmojnë indirekt përparimin ushtarak dhe teknologjik të Rusisë, duke shmangur sanksionet.

Sprocure është themeluar në gushtin e vitit 2022, gjashtë muaj pas fillimit të pushtimit rus të Ukrainës, me veprimtari të deklaruar si "ndërmjetësim në shitjen e produkteve të ndryshme".

Fillimisht, pronare dhe drejtoreshë ishte shtetasja e Serbisë, Zineta Mehmeti, por në fillim të vitit 2024, kur

Departamenti Amerikan i Shtetit ka filluar sanksionimin e kompanive nga Serbia, pronësia ka ndryshuar.

Pronari dhe drejtori i ri u bë shtetasi turk Erdal Lihan.

Në faqen zyrtare, Sprocure paraqitet si shpërndarës ndërkombëtar i pjesëve për industrinë e aviacionit, me synimin të ofrojë edhe menaxhim riparimesh dhe logjistikë. Sipas raportit të fundit financiar, kompania ka realizuar të ardhura prej 1.4 milion dollarësh në vitin 2024, ndërsa në vitin 2023 këto ishin 2.5 milionë dollarë.

"REL"-i i ka analizuar të gjitha eksportet që Sprocure ka bërë drejt Rusisë në 18 muajt e parë të veprimtarisë.

Sietëlli dhe Majami, pikënisje të disa dërgesave për në Rusi

Të dhënat doganore tregojnë se nga shtatori i 2022-s deri në fund të 2023-s, mallra me vlerë rreth 2 milionë dollarë u eksportuan nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës në Rusi, kryesisht përmes Turqisë. Pikat e nisjes ishin shpesh qytetet amerikane Sietell dhe Majami. Në Sietell ndodhet edhe selia e gjigantit të aviacionit Boeing. Të dhënat doganore tregojnë se



pjesë me vlerë prej 110 mijë dollarësh kishin shënimin e kësaj kompanie.

Në një përgjigje për REL-in, Boeing ka thënë se respekton të gjitha rregulloret dhe nuk eksporton mallra në Rusi.

"Në mars 2022 ndërpreme të gjitha operacionet kryesore në Rusi, përfshirë shpërndarjen e pjesëve, mirëmbajtjen dhe mbështetjen teknike për klientët", është thënë në përgjigje.

Një tjetër prodhues i madh i pajisjeve të avionëve, produktet e të cilit janë eksportuar në Rusi përmes Sprocure, është kompania amerikane Honeywell, me seli në Arizona. Kjo kompani furnizon rreth 90 për qind të avionëve dhe 80 për qind të satelitëve në botë. Vlera e produkteve të kësaj kompanie që përfunduan në Rusi është mbi 400 mijë dollarë.

Honeywell ka konfirmuar për REL-in se që nga viti 2022 ka ndaluar aktivitetin në Rusi dhe Bjellorusi, duke respektuar

plotësisht sanksionet dhe ligjet për eksportin. "Që nga ajo kohë nuk kemi shpërndarë asnjë pajisje, pjesë apo produkt në Rusi, dhe po punojmë aktivisht për të parandaluar çdo mundësi të devijimit të produkteve tona drejt Rusisë përmes palëve të treta", është thënë në përgjigje.

REL-i ka kërkuar gjithashtu informacione nga Shërbimi Doganor dhe Kufitar i ShBA-së, por kërkesa për të dhëna më të detajuara u refuzua.

Për mallra me vlerë mbi 7 milionë dollarë nuk ka të dhëna për markat, ndërsa për mallra me vlerë 5 milionë dollarë nuk dihet origjina. Për 2 milionë dollarë është caktuar origjina amerikane, ndërsa për 1.5 milionë dollarë origjina e deklaruar është Serbia. Sprocure nuk ka dhënë përgjigje në pyetjet e REL-it pasi është përfshirë në listën e zezë të BE-së.

Kush janë përfituesit kryesorë të dërgesave përmes Sprocure në Rusi?

Nga pala ruse, përfituesi më i madh i dërgesave të bëra përmes kompanisë Sprocure ishte kompania S7 Engineering, e cila ka pranuar mallra në vlerë prej 2 milionë dollarësh. S7 Engineering është degë e kompanisë ajrore Siberia

Airlines.

Kjo kompani ka nënshkruar kontrata edhe me institucionin shtetëror rus, Eskadroni i Aviacionit Special të Rusisë, që vepron në kuadër të Zyrës për Çështjet e Presidentit të Federatës Ruse. Afër 5 milionë dollarë mallra janë dërguar në kompaninë Jetica LLC, e cila sipas të dhënave në bazën e kompanive ruse Spark është e regjistruar si një kompani që operon në fushën e transportit ajror. Selia e saj ndodhet në Moskë dhe si pronare figuron Izmailova Darya Mikhailovna.

Radio Evropa e Lirë kishte raportuar më parë për aktivitetet e Sprocure në nëntor 2023, në një hulumtim për fitimet milionëshe të kompanive serbe përmes shmangies së sanksioneve ndaj Rusisë. Aty zbulohet se pajisje dhe pjesë të avionëve të prodhimit perëndimor eksportoheshin në Rusi përmes Sprocure nga Beogradi. Dërgesat përfshinin vajra për motorë avionësh, goma, pajisje sinjalizuese zanore dhe vizuale, bateri dhe akumulatoret. Asokohe, pronarja Zineta Mehmeti nuk iu përgjigj pyetjeve të REL-it. Sprocure është kompania e katërt nga Serbia që futet në listën e zezë të BE-së për sanksione ndaj Rusisë, pas Conex, Kominvex dhe Soha Info.

Emiratet e Bashkuara Arabe premtojnë investime prej 1.4 trilionë dollarësh në ShBA për 10 vjet

ABU DHABI, 16 MAJ - Presidenti i Emirateve të Bashkuara Arabe, Sheikh Mohammed Bin Zayed Al Nahyan, ka thënë se vendi i tij do të investojë rreth 1.4 trilionë dollarë në Shtetet e Bashkuara të

Amerikës gjatë dhjetë vjetëve të ardhshme si pjesë e marrëdhënieve, sipas tij, të shkëlqyeshme midis dy vendeve që nga rikthimi në pushtet i presidentit amerikan Donald Trump.

Trumpi ka qëndruar të enjten në Emiratet e Bashkuara Arabe në kuadër të udhëtimit të tij të parë jashtë vendit. Aeroplani presidencial "Air Force One" ishte shoqëruar nga avionë luftarakë në hapësirën ajrore

të vendit, njësoj siç ka ndodhur në ndalesat e tij në Arabinë Saudite dhe Katar. Gjatë qëndrimit të tij atje, Trumpi ka vizituar xhaminë Sheikh Zayed, një nga xhamitë më të mëdha në botë.



Behrami takon Grenellin:
Mbështetës i madh i Kosovës

UASHINGTON, 16 MAJ - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Artan Behrami, është takuar me ish-emisarin e posaçëm të Shteteve të Bashkuara për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell. Në “Facebook”, Behrami ka njoftuar për takimin, duke shpërndarë edhe një fotografi, ku të dy shihen në një ambient zyrtar, me flamurin amerikan në sfond.

Behrami e ka falënderuar Grenellin për mikpritjen dhe bisedën që e ka cilësuar konstruktive. “Me ambasadorin Grenell, një mbështetës i madh i Kosovës dhe një luftëtar i palëkundur për drejtësi!”, ka shkruar Behrami.

Kujtojmë se Behrami ka qenë këshilltar i ish-presidentit Hashim Thaçi, ndërkaq Grenelli kritik i ashpër i Gjykatës Speciale.



MUSLIU-SHOSHI: RRUGA EVROPIANE E KOSOVËS KA STAGNUAR, HUMBËM RASTIN PËR ANËTARËSIM NË KËSHILLIN E EVROPËS

PRISHTINË, 16 MAJ - Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës, Ariana Musliu-Shoshi, ka thënë se rruga evropiane e Kosovës ka stagnuar, pasi para dy ditësh Kosova humbi rastin e dytë për t’u anëtarësuar në Këshillin e Evropës.

Musliu-Shoshi, në një konferencë për medie, ka thënë se ky çast kyç që “do t’i hapte rrugë forcimit të subjektivitetit tonë ndërkombëtar, u humb për shkak të veprimeve të papërgjegjshme dhe arrogante të qeverisë Kurti”.

“Rruga evropiane e Kosovës jo vetëm që ka stagnuar, ajo ka marrë tatëpjetën. Vetëm para dy ditësh, me keqardhje të madhe, pamë si Kosova humbi edhe një rast të artë për t’u anëtarësuar në Këshillin e Evropës. Ju e dini se për vite me radhë është bërë një punë e madhe për anëtarësimin e vendit tonë në këtë organizatë të rëndësishme ndërkombëtare”, ka thënë ajo.

Deputetja e PDK-së ka shprehur keqardhje që këto ditë, kur të gjithë liderët evropianë janë mbledhur në Tiranë për të diskutuar për të ardhmen e kontinentit, Kosovës, të gjithë, pa përjashtim, kanë vendosur t’i vënë sanksione politike. “Sot, në Tiranë, për herë të dytë me radhë, po mbahet Samiti i Komunitetit Politik Evropian. E përgëzojmë kryeministrin e Shqipërisë, z. Edi Rama, për punën e jashtëzakonshme që ka bërë në këto katër vitet e fundit për ta afruar Shqipërinë me Bashkimin Evropian. I urojmë suksese të mtejshme drejt synimit të përbashkët – Shqipëria në BE deri më 2030”, ka thënë Musliu-Shoshi.

Sipas saj, kjo është një katastrofë politike për shkak të një qeverie të dobët, anemike, pa plan dhe pa vizion. “Kosova po humb qindra milionë euro ndihmë e mbështetje nga Bashkimi Evropian. E gjithë kjo si pasojë e izolimit ndërkombëtar që i është shkaktuar vendit nga një qeveri që nuk kupton dialogun, bashkëpunimin dhe përgjegjësinë. Në planin e njohjeve ndërkombëtare, Kosova ka stagnuar plotësisht. Jo vetëm që nuk ka pasur njohje të reja, por nuk ka pasur as përpjekje serioze për to.

Ministria e Punëve të Jashtme është kthyer në një sektor të paralizuar nga diletantizmi”, ka thënë ajo.

PDK-ja ka thënë se është e papranueshme, e jashtëligjshme dhe shpërdorim i votës së qytetarëve bllokada institucionale. “Tani jemi dëshmitarë të një situatë absurde: më shumë se tre muaj pas zgjedhjeve të 9 shkurtit, kjo

qeveri ka marrë peng institucionet e vendit. Ka bllokuar formimin e Kuvendit dhe të qeverisë së re, duke e çuar vendin drejt një krize të thellë kushtetuese dhe institucionale”, ka thënë Musliu-Shoshi.

Musliu-Shoshi ka thënë se është koha që Kosova të ketë një qeveri që punon për qytetarët dhe që është e aftë ta kthejë vendin në binarët e duhur drejt integritetit euroatlantik, zhvillimit ekonomik dhe forcimit të shtetësisë sonë. “Mjaft është mjaft. Bllokada politike po shkakton pasoja të mëdha në jetën e qytetarëve tanë dhe në ecurinë e shtetit tonë. PDK-ja ka kontribuar në zgjidhje të cilën, fatkeqësisht, ky pushtet i paligjshëm po refuzon ta dëgjojë. Çdo vonesë po i kushton Kosovës. Sot Këshilli i Evropës, nesër fondet ndërkombëtare, pasnesër diçka tjetër më e madhe”, ka thënë Musliu-Shoshi.

GJERMANIA HEQ TË DËRGUARIN PËR BALLKANIN PERËNDIMOR

BERLIN, 16 MAJ - Me një vendim të kabinetit, qeveria e re federale në Gjermani ka vendosur t’i shfuqizojë disa poste të dërguarish të posaçëm - përfshirë edhe postin për Ballkanin Perëndimor. Ky post ishte krijuar në vitin 2022 nga ministrja e atëhershme e Jashtme, Annalena Baerbock (Të Gjelbrit), për ta mbështetur procesin e afrimit të rajonit me Bashkimin Evropian.

Ministria e Jashtme e Gjermanisë i ka thënë “Deutsche Wellen (DW)” se ky vendim është pjesë e një premtimi qendror të qeverisë së re: shkurtimi dhe thjeshtimi i strukturave shtetërore. “Detyrat që më parë i përkisnin dërguarit të posaçëm do të kalojnë në sektorët përkatës të ministrisë”, i ka thënë një zëdhënës i ministrisë “DW”, duke shtuar se bashkëpunimi me vendet e rajonit do të vazhdojë të jetë i ngushtë dhe i thelluar, ndërsa Procesi i

Berlinit dhe mbështetja për anëtarësimin në BE do të mbeten prioritet të qarta.

Rol ndërmjetësues në Ballkanin Perëndimor

Manuel Sarrazin (Të Gjelbrit), i cili e ka mbajtur këtë post deri

tani, ka qenë një figurë shumë aktive në politikën gjermane për Ballkanin Perëndimor. Ai udhëtonte rregullisht në rajon, merrte pjesë në samite dhe ndërmjetësonte mes qeverive. Veçanërisht në kuadër të Procesit të Berlinit, Sarrazin pati një rol kyç në arritjen e marrëveshjeve për

mobilitetin në kuadër të Procesit të Berlinit. Në qeverinë e mëparshme tripartiake, Ballkani Perëndimor gëzonte një rëndësi të veçantë.

Në marrëveshjen e re të koalicionit mes socialdemokratëve dhe demokristianëve rajoni përmendet shumë pak. Edhe pse me ministrin e Jashtëm Johann Wadephul dhe ministrin e Evropës Gunther Krichbaum - Gjermania ka në krye të diplomacisë dy njohës të Ballkanit Perëndimor, rajoni nuk arriti të gjente vend as në fjalimin e kancelarit Merz e as në atë të ministrit të Jashtëm Wadephul, gjatë prezantimit të prioriteteve të tyre qeveritare të mërkurë, më 14 maj, në Bundestag.

Reagime të përziera në Bundestag

Deputeti i Të Gjelbërve, Boris

Mijatovic, e ka kritikuar heqjen e postit të të dërguarit të posaçëm për Ballkanin Perëndimor. Ai vlerëson se ky rol ishte një instrument i rëndësishëm politik për të dërguar sinjale mbështetjeje ndaj rajonit dhe për ta përshpejtuar integrimin në BE. “Siç duket, qeveria e re po largohet nga ideja e një afrimi të shpejtë të rajonit me Bashkimin Evropian”, ka thënë ai për “Deutsche Wellen”.

Deputeti i partisë bashkëqeverisëse SPD, Adis Ahmetovic, në të kundërtën siguron për “DW” se me Wadephul dhe Krichbaum qeveria e re ka në krye të diplomacisë figura me përvojë të thellë në rajon dhe çështja do të trajtohet në “nivel të lartë”. “Integrimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor do të mbetet prioritet i lartë për ne si grup parlamentar i SPD-së”, ka thënë Ahmetovic.



MBAHET SAMITI I LIDERËVE EVROPIANË NË KRYEQYTETIN E SHQIPËRISË

EVROPA BASHKOHET NË SHQIPËRI, LIDERËT DISKUTOJNË PËR SFIDAT E SIGURISË DHE TË MBROJTJES

Shqipëria, e drejtuar nga kryeministri Edi Rama, ka qenë nikoqire e samitit njëditor në të cilin kanë marrë pjesë liderët e shteteve evropiane. Në këtë samit është diskutuar për sfidat e sigurisë dhe të mbrojtjes. Në epiqendër ka qenë lufta në Ukrainë. Po në këtë samit është diskutuar edhe për procesin e integritetit në BE dhe për emigracionin. Kosova në këtë samit është përfaqësuar nga presidentja Osmani, e cila ka kërkuar nga BE-ja t'i heqë masat ndëshkuese ndaj Kosovës para vazhdimin të dialogut për normalizimin e marrëdhënies.

EPOKA E RE**Lirim GECI**

TIRANË, 16 MAJ - Liderët e 47 vendeve dhe organizatave evropiane kanë zbarkuar të premten në kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranë, për të marrë pjesë në Samitin e Komunitetit Politik Evropian. Për pritjen e liderëve evropianë në Tiranë është përkujdesur kryeministri i

Shqipërisë, Edi Rama. Në këtë samit janë diskutuar sfidat e sigurisë dhe mbrojtjes në të gjithë kontinentin e Evropës, me theks të veçantë për agresionin e Rusisë ndaj Ukrainës. Samiti i Tiranës, i cili është mbajtur me moton: "Evropa e re në një botë të re: unitet - bashkëpunim - veprim i përbashkët" është diskutuar edhe për mënyrat për ta

përmirësuar konkurrueshmërinë e kontinentit dhe për ta përballuar emigracionin e paautorizuar. Kryeministri Edi Rama, nikoqir i këtij samiti, në fjalën hapëse ka thënë se duhet të krijohet një Evropë e cila funksionon jo vetëm për mbrojtjen e saj me armë, por që arrin t'i plotësojë ëndrrat e çdo të riu. "Një politikë që sheh Evropën

jo si një fortesë mbrojtëse, apo një muze për t'u ruajtur, por si një shpirt i përbashkët që duhet mbrojtur, një fat i të gjithëve për t'u jetuar, e një e ardhme e përbashkët për t'u ndërtuar. Për ta bërë këtë nuk duhet investuar vetëm te qëndresa e mbrojtja, por te zemra e mendja që do ta mbartin shpirtin e Evropës. Më lini t'ju pyes, shumë të

dashur miq, pse të mos imagjinojmë një KPE të arsimit, shkencës, inteligjencës artificiale, një aleancë ndërkombëtare përtej armatimit? Një terren burimesh dijeje, kërkimi shkencor dhe informacioni, ku territoret që janë anëtare të BE, apo që ende nuk janë anëtare të BE-së, mund të bëhen kufij të rinj investimi.





Pa burokraci. Pa barra fiskale. Le t'u japim të rinjve të Evropës, bizneseve të reja, një arsye më të mirë për të qëndruar sesa të flasin vetëm për armë. T'u japim motiv të fortë për të ndërtuar e ëndërruar në tokën evropiane, në vend që të hedhin sytë lart për ta ndjekur ëndrrën e tyre. Beteja jonë duhet të jetë diçka që mund bëjmë ne për veten tonë, fëmijët tonë, Evropën tonë”, ka thënë Rama.

Duke u ndalur kalimthi te procesi i anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, Rama ka thënë se duhet të sigurohen se nuk është një rrugë thjesht kalimtare, por një “rikthim në shtëpi”. “Evropa edhe një herë ka një mundësi nga Zoti për ta rishpikur veten, të sigurojmë se rrugëtimi ynë nuk është rrugëtim rrëmbimi, por një udhëtim kthimi në rilindje, kthim në shtëpi. Një kthim në shtëpi që gëlon nga ëndrra për të ardhmen, e çliruar nga mitet e së shkuarës, e padyshim e mbrojtur mirë. Një shtëpi që nuk ngjan me formën e armëve, por me imagjinatën e fëmijëve tanë”, ka thënë Rama.

Ndërsa presidenti i Këshillit Evropian (KE), Antonio Costa, ka thënë se Evropa duhet të investojë më shumë në mbrojtjen e saj, në të kundërt paqja mbetet iluzion.

Nga lufta në Ukrainë deri në Lindjen e Mesme, presidenti i KE-së ka bërë thirrje për bashkim për të sjellë paqe të drejtë për një kohë të gjatë.

Liderët evropianë bëjnë thirrje për paqe dhe unitet

Kurse presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka bërë thirrje nga Tirana që Evropa të jetë e bashkuar në fushën e sigurisë, ekonomisë dhe shkëmbimeve tregtare. Në fjalën e tij në Samitin e Komunitetit Politik Evropian, Macroni ka thënë se në Ukrainë duhet të ketë një armëpushim në mes të Rusisë dhe Ukrainës. Në këtë kontekst, ai ka thënë se Evropa është në mbështetje të Ukrainës. “Duhet të këmbëngulim të sigurojmë paqe të qëndrueshme në Ukrainë. Unë shpresoj se do të ketë traktat paqeje mes Armenisë dhe Azerbajxhanit. Ne e mbështesim këtë gjë. Duhet mbështetur Moldavia ndaj agresionit të përditshëm nga Rusia, gjithashtu. E gjitha ka të bëjë me koordinimin mes nesh. Të gjithë i kanë sytë nga ne. Le të shpjegojmë se çfarë po bëjmë me Ukrainën. Kush thotë që kur vjen fjala për sovranitet territorial ju bërtisni që është kërcënim për jetën e jeni të heshtur kur bëhet fjalë për tragjedi humanitare. Na duhet paqe, diplomaci, unitet. Është e vështirë. Për të qenë të besueshëm duhet të kemi reagim të përbashkët. Na duhet një shtyllë e fortë evropiane në NATO dhe duhet të veprojmë së bashku”, ka thënë Macroni, i cili e ka uruar Ramën për fitoren në zgjedhjet

e 11 majit.

Në Samitin e Tiranës ka marrë pjesë edhe presidenti i Ukrainës Volodymyr Zelensky. Në fjalën e tij, ai ka thënë se Ukraina ka nevojë për një armëpushim të plotë dhe të pakushtëzuar. Zelensky, duke u ndalur te takimi i Stambollit në mes të delegacionit të Ukrainës dhe atij të Rusisë, e ka quajtur këtë të fundit një teatër, pasi delegacioni ishte i një niveli të ulët. Gjithashtu, presidenti ukrainas ka kërkuar lirim të pengjeve të mbajtura nga Rusia, teksa në fund të fjalës së tij ka theksuar edhe rëndësinë e ShBA-së për vendosjen e paqes në Ukrainë. Më tutje, presidenti i Turqisë, Rexhep Taipp Erdogan, ka thënë se mbrojtja e kontinentit evropian ka një rëndësi shumë të madhe. Ai ka vlerësuar se është i nevojshëm bashkëpunimi i të gjitha shteteve. “Tashmë më shumë se kurrë është e rëndësishme të veprojmë të bashkuar, mbi bazën e bashkëpunimit. Ka një potencial për bashkëpunim në fusha si mbrojtja, energjia, transporti e furnizimi, tregjet digjitale dhe lëndët minerale kritike. Janë shumë fusha ku ne mund të bashkëpunojmë. Në këto kohë kritike, kur diskutohet e ardhmja e sigurisë evropiane, përpjekjet e BE-së për ta zhvilluar industrinë e saj të mbrojtjes janë të dobishme. Besojmë se këto përpjekje duhet të përfshijnë edhe aleatë që nuk janë anëtarë të BE-së. Në mënyrë të tillë që të mos ‘fyejë’

rolin e NATO-s”, ka thënë Erdogan.

Pas Erdoganit ka folur kryeministri i Britanisë së Madhe, Keir Starmer. Ai ka bërë thirrje për paqe të drejtë dhe të qëndrueshme në Ukrainë. Ai e ka akuzuar presidentin rus, Vladimir Putin, se është duke bërë lojëra dhe se është kundër paqes. “Sfida më urgjente sot këtu është siguri i një paqeje të drejtë dhe të qëndrueshme. Duhet të bëjmë më shumë për mbrojtjen tonë. Tani duhet të jemi të përgatitur që ta ndjekim deri në fund sepse nëse Rusia nuk do të ulet në tryezën e diskutimeve, Putini duhet ta paguajë çmimin. Putini nuk e ka seriozisht paqen. Po tërheq këmbët zvarrë dhe po luan lojëra. Qartësisht Ukraina është pala e paqes”, ka thënë Starmeri, i cili ka folur edhe për çështjen e migracionit, duke kërkuar ngritjen e një sistemi të drejtë.

Në Samitin e Tiranës kryeministria e Italisë, Georgia Meloni, ka bërë thirrje për ribashkim të vendeve evropiane. Po ashtu, ajo ka thënë se Shqipëria është Evropë dhe se pa Ballkanin Perëndimor nuk ka një Evropë të re. “Në rast se dëshirojmë të ndërtojmë Evropën e re në një botë të re nuk mund ta bëjmë pa Ballkanin Perëndimor. Këta popuj janë ura mes Lindjes e Perëndimit dhe zemra e Evropës”, ka thënë Meloni, duke shtuar se do të qëndrojnë në krah të Ukrainës dhe do të

bëjnë të pamundurën për t'i dhënë fund luftës. “Do të vijojmë të qëndrojmë krah Ukrainës. Do të bëjmë të pamundurën që lufta të marrë fund menjëherë. Qëndresa e Ukrainës na kujton se çfarë është vërtet Evropa”, ka thënë ajo, e cila e ka uruar Ramën për fitoren në zgjedhjet parlamentare në Shqipëri.

Edhe kancelari gjerman Friedrich Merz ka thënë se është shumë e rëndësishme që të gjitha palët të bashkëpunojnë për një Evropë më të sigurt.

Merz në fjalën e tij është shprehur se tashmë është e qartë që demokracitë janë në rrezik dhe qeveritë duhet të tregojnë se janë të forta për të zgjidhur kriza siç është lufta në Ukrainë dhe emigracioni. “Ne jemi të vendosur që duhet të vazhdojmë t'i japim mbështetje të fortë Ukrainës në aspektin politik, ekonomik, financiar, ushtarak, këtij vendi në vështirësi të tmerrshme. Përpjekjet tona kanë treguar një sukses shumë të vogël diplomatik. Duhet të jemi të qartë për mbështetjen tonë”, ka thënë ai, duke kërkuar që Evropa ta ruajë aleancën me ShBA-në.

Edhe presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka mbajtur një fjalim në Samitin e Tiranës. Ajo ka bërë me dije se janë duke punuar për grupin tjetër të sanksioneve për Rusinë. “Vetëm fakti që jemi të ulur këtu së bashku me ju Volodymyr (Zelesnsyn), është





provë e bashkimit tonë të palëkundur, të çeliktë. Kjo tregon vendosmërinë tonë, e një bashkëpunim më të madh për të vendosur sovranitetin e Ukrainës, për të gjetur një rrugë drejt një marrëveshjeje paqeje e për të pasur garanci të forta sigurie për Ukrainën”, ka thënë ajo.

Ahmeti, Abdixhiku dhe Haradinaj përgëzojnë Ramën për Samitin e Tiranës

Për organizimin e Samitit të Tiranës ka pasur edhe reagime nga Kosova dhe Maqedonia e Veriut. Liderët partiakë e kanë përgëzuar kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama për organizimin e Samitit të Tiranës. Lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, është shprehur i entuziazmuar me Shqipërinë për organizimin e Samitit të Komunitetit Politik Evropian. Ai e ka lavdëruar kryeministrin Rama, duke thënë se ai e ka shndërruar Shqipërinë në një yll të Evropës. “I lumtur për Shqipërinë dhe shqiptarët teksa shoh liderët e të gjitha vendeve të kontinentit të vjetër, si asnjëherë më parë, duke përshkuar bulevardin e ‘Dëshmorëve të Kombit’ në Tiranë dhe tubohen nën mburojën e më të madhit ndër ne, Gjergj Kastrioti - Skënderbeu. Të lumtë Edi, Shqipëria tashmë është yll evropian! Uroj punë të mbarë samitit të Komunitetit Politik Evropian dhe përgëzoj Shqipërinë për mikpritjen bujare tradicionale dhe organizimin e shkëlqyer. Ditë të mira për Shqipërinë dhe shqiptarët”, ka shkruar Ahmeti. Ndërsa kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, e ka përshkruar Tiranën si epiqendër të re rajonale, ndërsa ka vënë në kontrast zhvillimet pozitive në Shqipëri me gjendjen që po përjeton Kosova, të cilën e cilëson të mbetur në vendnumëro, pa institucione funksionale dhe pa ndjenjën e urgjencës për kohën. “Kosova, ndërsa, vazhdon të mbetet nën masa e sanksione. Vazhdon të mbetet dhe pa institucione. Mbi të gjitha, vazhdon të mbetet pa ndjenjën e urgjencës për

kohën”, ka shkruar ai në rrjetet sociale. Sipas tij, zhvillimi, mirëqenia dhe përparimi shoqëror janë të paarritshme për një klasë politike që, siç thotë ai, është e përqendruar vetëm në shijimin e pushtetit. Abdixhiku ka bërë thirrje për një rizgjim kombëtar, duke deklaruar se ky rizgjim nuk mund të vijë nga ata që nuk e njohin nevojën, por nga vetë populli i Kosovës. Edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka përshëndetur Samitin e Komunitetit Politik Evropian në Tiranë. Ai ka vlerësuar se organizimi i këtij samiti në kryeqytetin shqiptar është një sinjal i fuqishëm për bashkëpunim dhe të ardhme evropiane të rajonit. Haradinaj e ka falënderuar Ramën për këtë organizim, duke thënë se Shqipëria po i jep zë Ballkanit Perëndimor. “E mirëpres Samitin e Komunitetit Politik Evropian në Tiranë, një sinjal i fuqishëm për bashkëpunim dhe të ardhmen evropiane të rajonit tonë. Falënderim për kryeministrin Edi Rama për rolin udhëheqës dhe për faktin që Shqipëria po i jep zë Ballkanit Perëndimor në

tryezat evropiane. Kosova duhet të trajtohet si partnere e barabartë. Populli ynë meriton njohje, dinjitet dhe një të ardhme të qartë brenda familjes evropiane”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.

Osmani: Të hiqen masat e BE-së ndaj Kosovës para dialogut me Serbinë

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, i ka bërë thirrje Bashkimit Evropian (BE) që t'i heqë masat ndëshkuese ndaj Kosovës para vazhdimit të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve. “Më parë duhet të flasim për heqjen e masave nga ana e BE-së, sepse kjo e dëmton edhe vetë kredibilitetin e BE-së”, ka thënë Osmani në Tiranë, ku ka marrë pjesë në samitin njëditor të Komunitetit Politik Evropian. “Këtë e kam kërkuar edhe mbrëmë gjatë darkës së



organizuar nga ana e BE-së, dhe do ta kërkoj edhe sot, sepse kjo do t'i jepte kredibilitet dialogut”, është shprehur presidentja e Kosovës. Osmani ka thënë se “Kosova është gjithnjë e gatshme dhe konstruktive që të marrë pjesë në këtë proces” që ndërmjetësohet nga BE-ja. BE-ja vendosi masa ndëshkuese ndaj Kosovës më 2023 - pas rritjes së tensioneve në veri të vendit dhe vazhdon t'i mbajë ato në fuqi me arsyetimin se Kosova nuk ka bërë ende mjaftueshëm për shtensionimin e gjendjes në veriun e banuar me shumicë serbe. Presidentja Osmani ka folur edhe për kandidaturën e Kosovës për anëtarësim në BE, teksa i ka bërë thirrje Brukselit të bëjë veprime konkrete.

“Kosova ka aplikuar për anëtarësim në BE para dy vjetëve por, për fat të keq, ende nuk është shqyrtuar aplikimi nga BE-ja për shkak të disa komplikimeve të panevojshme politike që krijohen nga disa shtete anëtare. Meqenëse ky është edhe samiti i 6-të i Komunitetit Politik Evropian, ka ardhur koha që, përtej fjalëve të bukura që u drejtohen shteteve aspiruese për anëtarësim, të ketë veprime konkrete. Është shumë me rëndësi që të kemi rezultate konkrete, në veçanti për shtete si Kosova, e cila është 100 për qind në linjë të plotë me vendimet e BE-së sa i përket politikës së jashtme dhe asaj të sigurisë”, ka thënë Osmani para gazetarëve.



Mbyllet një institucion paralel në veri, policia gjen në objekt prova për vepër penale

MITROVICË, 16 MAJ - Inspektorët e komunës së Mitrovicës së Veriut, asistuar nga Policia e Kosovës, kanë rikthyer në pronësi të komunës një ndërtesë në këtë qytet, e cila deri tani është shfrytëzuar nga strukturat paralele të Serbisë. Bëhet fjalë për institucionin e ashtuquajtur “Shërbimi kombëtar i punësimit”, i cili ka

funksionuar me mbështetjen e Beogradit zyrtar. Kështu ka thënë zëvendës-drejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani. “Sot kemi asistuar inspektorët komunalë në hyrje të ndërtesës që ata e konsiderojnë të tyre. Kur kemi hyrë në të kemi hasur në prova që ne konsiderojmë se

janë të kundërligjshme dhe përbëjnë vepër penale. Pas kontaktimit me prokurorin kujdestar, ndërtesa është mbyllur dhe ka mbetur që provat t’i dorëzohen prokurorit në mënyrë që të vendoset se si të lëvizet tutje. Nuk ka persona të arrestuar”, ka theksuar Elshani për “Klan Kosovën”.



LIROHEN 28 TË AKUZUARIT PËR KORRUPSION DHE VEPRA TË TJERA PENALE NË RASTIN E “PATENTËSHOFERËVE”

PRISHTINË, 16 MAJ - Gjykata Themelore në Prishtinë i ka liruar nga akuza për korrupsion dhe vepra të tjera penale 28 të akuzuarit në rastin e njohur si “Patentëshoferët”. Ata janë liruar pasi nuk është provuar se kanë kryer veprat penale për të cilat janë ngarkuar. Aktgjykimi lirues është shpallur të premten nga kryetarja e trupit gjykues, Fatime Dermaku. Sipas gjykatëses Dermaku, gjatë rrjedhës së procedurës, Gjykata ka marrë aktvendim me të cilin ka revokuar vendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake, të dëshmitares bashkëpunuese Adelina Gashi, dhe ka shpallur provat të papranueshme - konkretisht, masat e fshehta të përgjimeve, pasi ato janë marrë pa aktvendim për fillimin e hetimeve, kjo për shkak se personave kundër të cilëve janë lëshuar urdhrat, u janë ditur të



dhënat personale. Sipas saj, gjykata ka konstatuar se masa për sigurimin e veprës penale, edhe pse është realizuar përmes një personi të infiltruar, është ndërmarrë pa aktvendim

për fillimin e hetimeve. Ajo ka shtuar se kjo aktakuzë është ngritur mbi bazën e masave të fshehta. Të pandehurit nuk i dinë veprimet inkriminuese, ndërkohë që aktakuza është

përpiluar në mënyrë të përgjithshme, përkundër faktit që ajo është kthyer për plotësim. Ndryshe, në seancën e 14 qershorit 2023, 28 nga 31 të

akuzuarit ishin deklaruar të pafajshëm për akuzën e ngritur më 31 mars 2021 nga Prokuroria Themelore në Prishtinë. Në këtë rast, për korrupsion dhe vepra të tjera penale akuzohen: Naser Llugaliu, Filloreta Ajvazi, Flora Ferizi, Adem Binakaj, Leurat Shehu, Agim Restelica, Flamur Lekaj, Shaban Zuka, Eduard Brahimaj, Dragan Zhivković, Naser Bislimi, Azem Miftari, Labinot Ajeti, Magbule Mehmeti, Avdush Topalli, Premtim Topalli, Selim Rrustemi, Fatos Ferizi, Besfort Pozhegu, Naim Thaqi, Sylë Bejta, Ekrem Latifi, Dritmir Islami, Murtez Rama, Hasan Hasani, Milazim Demolli, Lindita Hoxha, Enver Fazliu, Burim Jashari, Fejzullah Ejupi dhe Bashkim Jetullahu. Për Burim Jasharin, Fejzullah Ejupin dhe Bashkim Jetullahun, procedura penale ishte veçuar (për secilin veç e veç).

RRITET NDJESHËM NUMRI I NDËRHJRJEVE KIRURGJIKALE NË KLINIKËN E ORTOPEDISË



Prishtinë, 16 maj - Klinika e Ortopedisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës ka bërë me dije se gjatë tremujorit të parë të vitit 2025 është shënuar rritje e ndjeshme e numrit të ndërhyrjeve kirurgjike - protezave të realizuara. Gjatë kësaj periudhe kohore janë kryer gjithsej 124 ndërhyrje ortopedike-proteza, nga lista e pritjes, krahasuar me vetëm 52 operacione të realizuara në të njëjtin tremujor të vitit të kaluar. “Kjo rritje përfaqëson një sukses të dukshëm në angazhimin dhe performancën e stafit të

Klinikës. Mirënjohje për stafin, të cilët me përkushtim e profesionalizëm po e përballojnë volumin në rritje të punës, në shërbim të pacientëve nga e gjithë Kosova”, është thënë në njoftimin e ShSKUK-së. Pavarësisht prej rritjes së numrit të operacioneve, ShSKUK-ja ka theksuar se ende ekziston lista e pritjes, por po punohet për t’u rritur edhe më tutje vëllimi i punës, por si klinika e vetme terciare në vend, Klinika e Ortopedisë mbetet e mbingarkuar me raste. “Aktualisht klinika është e furnizuar në mënyrë të

mjaftueshme me proteza, gjë që ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit të shërbimeve. Po ashtu, gjatë këtij viti pritet që ShSKUK, për herë të parë të furnizojë me proteza spitalet e përgjithshme në vend, që do të kontribuojë në shpërndarjen më të drejtë të ngarkesës dhe shkurtimeve e listave të pritjes. Klinika e Ortopedisë mbetet e përkushtuar në ofrimin e shërbimeve të avancuara dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë pacientët që kanë nevojë për trajtim ortopedik në Republikën e Kosovës”, ka njoftuar ShSKUK-ja.

Rritet numri i lindjeve në Kosovë, vetëm gjatë marsit lindën 2 061 fëmijë

PRISHTINË, 16 MAJ - Vetëm gjatë muajit mars të këtij viti në Kosovë kanë lindur 2 061 fëmijë. Kjo është një rritje prej pesë përlindësh krahasuar me një muaj më parë, gjatë shkurtit. Këto të dhëna janë publikuar nga Agjencia e Statistikave e

Kosovës (ASK). Me numër të lindjes vazhdojnë të prijnë meshkujt. Gjatë marsit të këtij viti kanë lindur 1 074 meshkuj dhe 987 femra. “Duke u bazuar në të dhënat administrative për muajin mars janë

regjistruar 2 061 lindje të ndodhura në Kosovë dhe jashtë Kosovës, prej tyre meshkuj 1 074 dhe femra 987. Krahasuar me muajin shkurt 2025 kemi rritje të numrit të lindjeve për (5 për qind)”, është thënë në raportin e ASK-së.



NË 26-VJETORIN E ZHDUKJES SË UKSHIN HOTIT, KURTI AKUZA NDAJ PROKURORISË SPECIALE

PRISHTINË, 16 MAJ - Të premten janë bërë 26 vjet nga zhdukja e intelektualit dhe politikanit Ukshin Hoti. Në këtë përvjetor kryeministri në dorëheqje, Albin Kurti, ka reaguar me një deklaratë të fuqishme, duke i akuzuar institucionet e drejtësisë në Kosovë për neglizhencë të qëllimshme dhe heshtje të pajustificueshme përballë një krimi të rëndë shtetëror të kryer nga autoritetet serbe gjatë luftës. Kurti ka theksuar se, megjithëse ekzistojnë dokumente autentike dhe dëshmi të shumta rreth zhdukjes së Ukshin Hotit më 16 maj 1999 nga Burgu i Dubravës, Prokuroria Speciale dhe gjyqësori i Kosovës nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim konkret në drejtim të hetimit apo ngritjes së një aktakuze - qoftë edhe në mungesë të të dyshuarve. “16 maji i vitit 1999, dita e lirimit të Ukshin Hotit nuk ishte dita e daljes së tij në liri, por dita e zhdukjes së tij. Që nga ajo ditë, Ukshin Hoti është një ndër personat e



zhdukur me dhunë nga forcat dhe autoritetet shtetërore të Serbisë gjatë kohës së luftës në Kosovë. Në ditët pasuese pas zhdukjes së Ukshin Hotit, autoritetet shtetërore të Serbisë kryen një masakër të madhe dhe të llahtarshme ndaj të burgosurve shqiptarë në Burgun e Dubravës, një tjetër krim shtetëror ky i Serbisë. Megjithëse këto dokumente sikur edhe të tjera relevante janë publikuar që në

vitin 2011 nga Ukë Thaçi në librin ‘Masakra në burgun e Dubravës’ dhe megjithëse shumë të burgosur të tjerë në Burgun e Dubravës atë kohë, kanë dëshmuar për rrethanat e zhdukjes së Ukshin Hotit, sistemi prokurorial dhe gjyqësor i Kosovës, nuk ka ngritur aktakuzë qoftë dhe në mungesë të të dyshuarve, për rastin e Ukshin Hotit. Mungesa e veprimit nga Prokuroria Speciale e Kosovës mbetet

boshllëk i dhimbshëm në përpjekjen tonë kolektive për drejtësi dhe për të vërtetën. Institucionet tona të drejtësisë e kanë obligim moral dhe kushtetues që të veprojnë me përgjegjësi, për të mos lejuar që harresa ta zëvendësojë drejtësinë”, ka shkruar Kurti në “Facebook”, duke kërkuar që të zbardhet rasti Ukshin Hotit. “Republika e Kosovës kërkon zbardhjen e plotë të rastit të zhdukjes së Ukshin Hotit dhe drejtësi për të, sikur edhe për të gjithë të zhdukurit e tjerë me dhunë. Politikani e profesori Ukshin Hoti do të mbetet një nga figurat më të rëndësishme të historisë së Kosovës e unike të mendimit politik shqiptar”, ka shkruar Kurti. Veprimtari i mirënjohur i Lëvizjes Kombëtare, profesori Ukshin Hoti, ka lindur më 17 qershor 1943 në Krushë të Madhe të Rahovecit. Ishte profesor, shkrimtar, filozof, intelektual, atdhetar dhe veprimtar i shquar i çështjes kombëtare gjatë viteve 1981-1999. Ukshin Hoti ka qenë

edhe ligjërues në disa universitete të Amerikës, ku edhe kishte studiuar dhe kishte diplomuar. Për aktivitetin e tij atdhetar ishte arrestuar disa herë nga regjimi serb i Titos dhe i Millosheviqit. Për herë të fundit ishte arrestuar në vitin 1994 nga policia serbe me akuzën e ushtrimit të veprimtarisë armiqësore kundër Jugosllavisë dhe për pjesëmarrjen e tij në lëvizjen për Republikën e Kosovës, me ç’rast ishte dënua pesë vjet burg. Më 16 maj 1999, pas lirimit dhe daljes nga qelia e burgut të Dubravës, zhduket nga polica serbe pa lënë gjurmë. Shokët e burgut, ata që kanë shpëtuar nga masakra në Dubravë, disa ditë më vonë kanë treguar se Ukshini ishte liruar nga burgu më 16 maj, ditë e diel, në të cilën nuk praktikohet lirim i të burgosurve. Prej asaj kohe e deri tani, atdhetari i përkushtuar Ukshin Hoti edhe sot e kësaj dite konsiderohet i zhdukur.

ÇFARË PËRFITON KOSOVA NGA CISMOA, PAKTI QË LIDHI ME SHBA-NË?

PRISHTINË, 16 MAJ - Shkëmbimi i sigurt i informacioneve dhe rritja e ndërveprueshmërisë ndërmjet ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) është formalizuar me një pakt ndërmjet dy vendeve. Marrëveshja për Ndërveprueshmëri dhe Siguri në Komunikim (CISMOA) është nënshkruar në fillim të kësaj jave nga gjeneralmajori amerikan John Phillips dhe gjenerallejtënanti i FSK-së, Bashkim Jashari, në Prishtinë. Kosova është shteti i 33-të me të cilin ShBA-ja ka nënshkruar marrëveshjen e tillë. Nga Ambasada Amerikane në Prishtinë, pakti është cilësuar “hap i madh përpara në forcimin dhe sigurinë e të dyja kombeve”, ndërsa nga pala e Kosovës si marrëveshje “e rëndësishme së veçantë”.

Çfarë është CISMOA?

ShBA-ja nënshkruan CISMOA-n me partnerë ndërkombëtarë, për të mundësuar shkëmbimin e sigurt të informacioneve të ndjeshme ushtarake dhe përdorimin e pajisjeve të avancuara të komunikimit. Ministri në detyrë i Mbrojtjes i Kosovës, Ejup Maqedonci, ka shpjeguar për Radion Evropë e Lirë (REL) se SHBA-ja është ndër partnerët kryesorë të bashkëpunimit ushtarak, prej nga FSK-ja siguron “shumicën e armatimeve dhe pajisjeve”. Ndër to janë edhe ato me teknologji të avancuar, me të dhëna kriptografike, dhe që “në vete kanë shumë elementë të ndjeshëm”. CISMOA, ka thënë Maqedonci,

“mundëson që ne - përveç t’i vazhdojmë blerjet – këto pajisje t’i kemi në përputhshmëri me pajisjet dhe me sistemet në ShBA”. Ish-kryeinspektori i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë dhe eksperti për çështje të sigurisë, Burim Ramadani, ka thënë për REL-in se pakti i ri paraqet elementin e simbolikës dhe të mbështetjes së SHBA-së për Kosovën, në veçanti për sektorin e sigurisë. CISMOA, sipas Ramadanit, “nënkupton që FSK-ja avancoi në komunikim dhe përdorim të pajisjeve të njëjta, në sistem të njëjtë, në linjën e njëjtë me ushtrinë amerikane, në raste të operacioneve të përbashkëta dhe ndërveprueshmërisë”. Ai ka shtuar se marrëveshja përfshin edhe shkëmbimin e informacioneve dhe të inteligjencës ushtarake. “Kjo është pjesë goxha me rëndësi. Sapo të themi ‘shkëmbim informacionesh’ dihet se jemi duke folur për informacione të klasifikuara”, ka thënë n Ramadani.

Si i ndihmon CISMOA Kosovës?

Autoritetet e Kosovës kanë thënë se përmbytja e marrëveshjes së re me ShBA-në mbulon shumë fusha dhe aspekte të bashkëpunimit ushtarak. Pjesa më e madhe e marrëveshjes është e klasifikuar dhe nuk mund të jetë transparente për publikun, sipas Ministrisë së Mbrojtjes së Kosovës. Megjithatë, për çështjet që tashmë janë të njohura për publikun, Maqedonci ka



shpjeguar me terma konkretë se çfarë përfiton Kosova nga CISMOA. Për shembull, sistemi raketor kundërtank Javelin, në proces të blerjes së të cilit është Kosova, sipas Maqedoncit përmban të dhëna që kanë një lidhje me teknologjinë e avancuar. CISMOA ia mundëson FSK-së qasjen e drejtpërdrejtë, përmes kanalit të sigurt të komunikimit, në të dhënat e ndjeshme që përmban sistemi, si dhe në përditësimin që u bëhet atyre të dhënave, për përdorim më efektiv, thotë ai. “Pra, nuk kemi nevojë për kërkesa shtesë dhe procedura burokratike, por kjo marrëveshje na mundëson qasje në të dhënat, në elementë sensitivë dhe të klasifikuar të këtij sistemi, dhe që e kanë bazamentin në ShBA”, ka thënë Maqedonci. Ai ka shtuar se CISMOA mundëson të njëjtën qasje në elementët e klasifikuar edhe për helikopterët amerikanë Black Hawk (Skifteri i Zi), për të cilët autoritetet e Kosovës kanë shprehur publikisht interesimin që t’i kenë në inventar të FSK-së. Kjo marrëveshje, siç ka thënë

Maqedonci, i hap mundësi Ministrisë së Mbrojtjes së Kosovës që të vazhdojë me blerjen e pajisjeve dhe armëve nga SHBA-ja, sipas konceptit “shtet me shtet”, duke prokuruar drejtpërdrejt me qeverinë amerikane. Vendet që nuk janë pjesë e CISMOA-s nuk mund ta kenë këtë qasje në të dhënat e përditësuara të pajisjeve ushtarake me elementë sensitivë dhe të GPS-ve (Sistemi i Pozicionimit Global), pa kërkesë të veçantë nga ato dhe pa aprovim të veçantë nga ShBA-ja, tregon ministri në detyrë i Mbrojtjes i Kosovës. Sistemi i komunikimit të sigurt, që garanton CISMOA, konsiderohet i domosdoshëm për shtetet që duan të ndërtojnë partneritet ushtarak, dhe si i tillë partneriteti mund të bëhet në baza të besueshmërisë së ndërsjellë. Ramadani ka thënë se besueshmëria ndërlidhet me shkëmbimin e informacionit në mënyrë të sigurt dhe komunikim me pajisje të sigurta ndërmjet dy ushtrive. Në rastin konkret, sipas tij, FSK-

ja do të avancojë në përdorimin e linjës së sigurt me ShBA-në. Kjo, sipas Ramadanit, do të thotë komunikim i drejtpërdrejtë - me pajisje të njëjta dhe me sistem të njëjtë, ndërmjet dy ushtrive - në të cilin masat e sigurisë dhe shkëmbimit të informacioneve janë të larta. “Pra, nuk mund të përgjohen nga shtete apo organizata armiqësore”, ka thënë Ramadani. Ndonëse ushtritë e secilit vend kanë rregullat e veta të funksionimit të brendshëm dhe të komunikimit, Ramadani thotë se, me marrëveshjen e arritur, në rast të ndonjë bashkëveprimi ndërmjet njësive të FSK-së dhe njësive të ushtrisë së SHBA-së, në ndonjë mision paqësor apo stërvitje ushtarake të përbashkët, do të vlente vetëm rregulli i funksionimit të brendshëm i ushtrisë amerikane. “FSK-ja dhe ushtria amerikane do të kenë procedura dhe standarde të njëjta, si dhe mënyrën e veprimit të njëjtë. Pra, sikurse (FSK-ja) të jetë një njësi e ushtrisë amerikane, në kuptimin e sistemit të komunikimit me ta”, ka thënë ai.

BAJRAMI PARAQET TË DHËNAT E ASK-së: NË QEVERINË KURTI KA LULËZUAR IMPORTI I ENERGJISË ELEKTRIKE

PRISHTINË, 16 MAJ - Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Hykmet Bajrami, ka publikuar të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) për import të energjisë elektrike. Në bazë të këtyre të dhënave, ajo ka treguar se sot kemi kompani që merren me tregtim të energjisë që vetëm pas tri viteve operimi në Kosovë hyjnë në top 10-shën për nga qarkullimi. Bajrami ka shkruar në “Facebook” se në qeverinë Kurti ka lulëzuar importi i energjisë elektrike. “Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, agjenci kjo që operon brenda zyrës së kryeministrit, në mandatin e qeverisë Kurti ka lulëzuar importi i energjisë elektrike. Si ‘rezultat’ i

varësisë nga importi dhe menaxhimit të dobët, të qëllimshëm, sot kemi kompani që merren me tregtim të energjisë që vetëm pas tri viteve operimi në Kosovë hyjnë në top 10-shën për nga qarkullimi”, ka shkruar ajo, duke treguar për shtrenjtimin e energjisë elektrike. “Çmimi i energjisë për konsumatorët familjarë është rritur për 128 për qind për ata që shpenzojnë mbi 800 KWh, e nga 1 qershori rreth 1 300 ndërmarrjeve vendore që punësojnë gjysmën e atyre që punojnë në sektorin privat, rrezikojnë t’u trefishohen faturat e energjisë elektrike. Disa prej këtyre ndërmarrjeve kanë deklaruar tashmë se nëse kjo ndodh, ata do ta kenë të pamundshme operimin në



tregun vendor dhe atë ndërkombëtar. Për me tepër kjo do ta sjellë edhe një valë të re të inflacionit që do ta godasë secilën familje në vend”, ka shkruar Bajrami, duke treguar kontributin e qeverisë Kurti në këtë drejtim.

“E në krejt këtë katrahurë, roli i qeverisë është i pamohueshëm: përmes lidhjeve me Martinin dhe të tjerët, përmes tenderëve të ndarë në ‘WhatsApp’, përmes dështimit të Ministrisë së Ekonomisë për të mbikëqyrë KEK-un, që në

vend se të kryejë remontet gjatë verës i shtyn ato për dimër, duke na detyruar të importojmë në kohën kur energjia është më e shtrenjtë. Kështu qytetarët dhe bizneset paguajnë faturën, ndërsa përfituesit janë ata që sot me të drejtë quhen ‘mafi energjetike’. E normal për deputetin Kurti nuk ka urgjencë të themelimit të institucioneve. Është një fjalë e urtë që thotë: ‘Zullumi këputet prej së trashi’. Për këtë arsye ne mendojmë se vendi është në krizë institucionale dhe jo vetëm dhe për këtë arsye një Qeveri kalimtare është e nevojshme që të merret me problemet dhe hallet e qytetarëve dhe të bizneseve. Pak e shumë, gjendja si në energjetikë është edhe në fushat tjera”, ka shkruar Bajrami.

PARAQITET PROJEKTI “SOLAR 4KOSOVO II”, INVESTIM MBI 80 MILIONË EURO PËR ENERGJI TË GJELBËR NË PRISHTINË

PRISHTINË, 16 MAJ - Kompania “Termokos” ka organizuar të premten një prezantim publik informues për projektin “Solar 4Kosovo II”, projekt ky që përfaqëson një hap drejt dekarbonizimit dhe zgjerimit të sistemit të ngrohjes qendrore në Prishtinë përmes energjisë së rinovueshme. Në këtë prezantim kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka theksuar rëndësinë shumëdimensionale të projektit, duke shtuar se ky do të kontribuojë në tranzicionin energjetik të Kosovës. “Projekti konsiston në ndërtimin e një centrali diellor me kapacitet prej 50 MGW për t’i siguruar kapacitetet shtesë të energjisë ngrohëse dhe zgjerimin e rrjetit të ngrohjes qendrore në Prishtinë. Fushëveprimi i projektit zbatohet në faza. Në fazën e parë e kemi një zgjerim shtesë prej 50 MGW. Një zgjerim i mëtejshëm i rrjetit do të jetë



edhe prej 20 MGW shtesë, një kapacitet total prej 70 MGW që do të merret në konsideratë edhe në një fazë të mëvonshme, në varësi të kujdesit të mëtejshëm duke përfshirë konfirmimin e përputhshmërisë edhe me Marrëveshjen e Parisit. Projekti do të ndihmojë kryesisht në promovimin e tranzicionit të

gjelbër duke kontribuar në zbutjen e ndryshimeve klimatike. Termocentrali i ri dhe rrjeti i zgjeruar i ngrohjes qendrore do t’i zvogëlojë emetimet e dyoksidit të karbonit, do ta përmirësojë cilësinë e ajrit në gjithë kryeqytetin dhe do ta integrojë furnizimin me energji të rinovueshme në sistemin e

ngrohjes qendrore të Prishtinës”, ka thënë ai. Sipas kryetarit Rama, projekti financohet nga një sërë burimesh, me një kosto të përgjithshme prej rreth 80.5 milionë eurosh. “Do t’u shërbejë lagjeve që nuk janë të lidhura me sistemin e ngrohjes qendrore duke zëvendësuar sistemet individuale të ngrohjes të bazuar në ngrohje elektrike direkte. Është një kosto e cila është përafërsisht 80.5 milionë euro. Shuma e grantit të KFW për këtë projekt është 31.6 milionë euro dhe shumën e grantit të WBF është 22.5 milionë euro, e ndarë në një grant investimi prej 16.5 milionë eurosh dhe një grant asistencë teknike prej 6 milionë eurosh. Përfshirë këtu edhe 100 mijë euro për aktivitet të komunikimit. Ndërsa kontributi vetjak do të jetë 4.4 milionë euro dhe financimi shtesë në shumën 22 milionë euro parashihet të

sigurohet nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim”, ka thënë Rama. Ndërsa drejtori ekzekutiv i Termokosit, Fisnik Osmani, ka bërë me dije se projekti do ta zgjerojë rrjetin e ngrohjes në pjesë të reja të kryeqytetit. “Projekti do të mundësojë shtrirje të rrjetit në disa pjesë të Prishtinës, e që është pika e fundit që e kemi pasur me kryetarin Rama në pjesë të programit katërvjeçar. Për pjesën e zgjerimit të rrjetit në tërë Prishtinën, është çështje muajsh që do të dalim me analizën për komplet Prishtinën, duke e ndarë të njëjtën në 11 zona të reja”, ka thënë Osmani. Në anën tjetër, menaxheri i projektit, Felix Eckert, ka sqaruar komponentët teknikë dhe përfitimet energjetike të projektit. Ai ka bërë me dije se ky projekt do ta mundësojë lidhjen e rreth 200 ndërtesave të mëdha.

Punëtorët e “Pastrimit” protestojnë të hënë

Prishtinë, 16 maj - Sindikata “Punëtori”, e kompanisë rajonale të mbeturinave “Pastrimi”, ka njoftuar se do të organizojë protestë më 19 maj (e hënë), në orën 10:00, përpara objektit të komunës së Prishtinës, si reagim ndaj mungesës së përgjigjes institucionale për një sërë shqetësimesh që lidhen me trajtimin e ndërmarrjes publike dhe të punëtorëve të saj. Në njoftimin zyrtar të sindikatës thuhet se protesta

është e domosdoshme për shkak të mosreagimit të komunës ndaj kërkesës së parashtruar më 15 maj. Kërkesat dhe shqetësimet kryesore të sindikatës përfshijnë: diskriminim në pagesa, pasiguri në punësim, mungesë transparence, mosdorëzim i mjeteve të punës, mungesë transparence për kontrata e shqetësime për favorizim të kompanive private përkundër kapaciteteve dhe përvojës së gjatë të KRM “Pastrimi”.

Sindikata ka theksuar se “politikëbërja” dhe përplasjet institucionale po u kushtojnë punëtorëve me pasiguri dhe mundësi humbjeje të vendeve të punës”. Në protestë punëtorët synojnë të kërkojnë trajtim i barabartë për ndërmarrjen publike, siguri dhe dinjitet në punë për punëtorët, transparencë dhe zbatim i ligjit nga komuna e Prishtinës, publikim i kontratave dhe vendimeve që prekin ndërmarrjen e ndalje të



gasjeve të dëmshme politike dhe institucionale ndaj punëtorëve. Protesta do të jetë

paqësore dhe synon të nxisë përgjegjësi institucionale, theksohet në fund të njoftimit.

NJË SIMFONI HORRORSHO PËR ZGJEDHJEN, DHUNËN DHE SHPIRTIN QË S’MUND TË BURGOSSET



Nga: Xhoina SALAJ

Le të ulemi pak si drugë, o vëllezërit e mi, e të vidojmë këtë vepër çudjesni të Antoni Bërzhësit, një çellovjek bolshoi që ka prodhuar një raskaz jo vetëm për të na tolçokur rasudokun, por edhe për të na mbushur gollovën me veshçe që ziejnë si molloko: çfarë është njeriu kur nuk zgjedh dot më? Çfarë është një shpirt pa mëkatin dhe virytin? Hë, pra, si i bëhet në këtë rast?

Nga qumështorja “Korova” në spitalin e shpirtit të shtrydhur

Historia e këtij libri na shpie në një Angli distopike, ku Aleks, një malçik që e ka zemrën si një bombë me sahat, udhëheq drugët e tij në netët e pafundme të grabitjeve, përdhunimeve e vrasjeve, pa ia bërë syri tërë. Ata janë regjisorët e një opere ultradhune, të mbështjellë në simfonitë e Bethovenit dhe në dritat e neoneve të natës. Po si çdo brat që vrapon shumë, edhe Aleks rrëzohet. E nuk bie vetëm në burg, vëllezërit e mi, por mu në duart e shtetit, i cili nuk kërkon drejtësi, por bindje. Ai i nënshtrohet teknikës Ludovik, një terapi e re ku i mbajnë me forcë sytë hapur dhe e detyrojnë të ndiejë neveri ndaj dhunës dhe ndaj muzikës, që të

shndërrohet si me magji në një qytetar që s’ke ç’i thua.

Aleksin s’e duam, por s’e heqim dot nga mendja

Aleks është zemra që rreh fort e pa ritëm. Ai është rrëfimtari i ftohtë, protagonist i sarkastik, një brat që e vidon botën me një sy të nxehtë dhe një tjetër të ngrirë, një nadsat që të flet ëmbël, ama që të vë edhe një britv në grykë. Është maska e bukur e djallit dhe pasqyrimi më i kthjellët i pyetjes që shtrën Bërzhësi: a ka më keq se detyrimi për të qenë i mirë, e ku nuk ke nga t’ia mbathësh? O vëllezërit e mi, nuk ka çellovjek tjetër që ta mbushë romanin me aq shumë bjezumni të errëta sa Aleks, bratit që kërkon veç zhurmë dhe kaos, por që fshihet pas simfonive të Ludvig Vanit. E për të kuptuar disi mendjen e këtij brati, duhet të futesh thellë–thellë në dhomën e tij, të veshësh teshat që mban, e të përpiqesh të depërtosh në bombën me sahat që ka në gjoks. Aleks nuk është thjesht i keq: ai është i lirë. Ai zgjedh dhunën, zgjedh të tolçokojë e të dratojë djevočka dhe babushka nëpër noçit e errëta, e të qeshë përmes britmave si pa gjë të keq. E ç’është më e keqja, kjo zgjedhje nuk është pasojë e traumës, nuk është viktimitë klasike, sepse ai e thotë vetë që e bën nga kënaqësia. E këtu qëndron gjithë tmerrri: ai e di se


ç’bën dhe vazhdon në të njëjtën rrugë. Aleks djali nuk është një antihero, por një eksperiment i pastër i filozofisë së lirisë absolute, ku asgjë s’e ndalon një njeri nga ndjekja e impulsit dhe instinktit të vet, për sa kohë që e zgjedh me vullnet të plotë, që është më e tmerrshme se çdolloj diktature: një brat që e do të keqen dhe botën grazhni! Ai e kontrollon rrëfimin më së miri. I jep formë, ritëm, melodi, që të ngroh me gjuhën e përdorur, por të ftoh me kuptimet që fshihen mes rreshtave; të fut në brendinë e dhunës pa iu dridhur qerpiku e pa të kërkuar falje. Madje të bën edhe bashkëpunëtor, një gllupiot që e shijon operën e tij. Shpeshherë të flet si mik, si drug, të quan vëllain e tij që po dëgjon rrëfimtarin e përlur, e pak nga pak të rrëmben në anën e tij pa e kuptuar. E vetëm kur vjen bitvi e hidhur e teknikës Ludovik, kuptojmë horrorsho se ishim brenda tij, por ai kurrë nuk qe brenda nesh, sepse është mjeshtër i maskës.

Një portokall me kurdisje në duar akull të ftohta

Togfjalëshi “portokall me kurdisje” është i pazakontë, i huaj për veshin dhe i vështirë për t’u kapërdirë me të parën. Vetë autori e ka thënë se shprehja i ka rënë në vesh gjatë një nate në Londër, nga një plak që e përdorte në dialektin

cockney, për të përshkruar diçka të çuditshme, të papërshtatshme, të kundërnatyrshme: as queer as a clockwork orange. Një portokall mekanik është një përbindësh simbolik: një frutë e bukur, e gjallë, e natyrshme në dukje, por që në vetvete është një makineri që lëviz jo sipas dëshirës së vet, por sipas prirjeve të jashtme të programuara. Këtu qëndron gjithë esenca dhe ironia therëse e librit: njeriu, për të qenë e për të jetuar si njeri, duhet të ketë liri, qoftë edhe atë për të qenë i keq, se pastaj mbetet një mekanizëm që lëviz siç i thonë; një frutë e bukur, por i kalbur; një makineri që bën zhurmë, por nuk këndon më. Titulli ngërthen kontrastin e madh midis natyrores dhe artificiales. Portokalli është simbol i jetës, i natyrës, i shijes dhe ngjyrës, një metaforë klasike për njeriun, ndërsa kurdisja përfaqëson automatikun, mekanizmin, rregullin e ftohtë, procesin që nuk lejon devijim e aq më tepër logjikë. Bashkimi i këtyre dy poleve krijon një figurë groteske, një hibrid të panatyrshëm që është në qendër të romanit: Aleks djalin e trajtuar dhe shpirtin e tij të ndaluar. Pra, njeriu bëhet si një portokall që nuk shtrydhet, por mbushet me ingranazhe; një krijesë që duket njerëzore, por vepron vetëm siç i është urdhëruar.

Pse mëkati është i rëndësishëm për shoqërinë? Antoni Bërzhës ishte i ndikuar thellë nga filozofia katolike, por edhe nga eksperimentet e shekullit XX për trurin dhe lirinë e njeriut. Për të, një njeri që s’mund të mëkatojë, nuk është më i virtytshëm, por veç një qenie e zbrazët. Çfarë ndodh kur autoritetet tentojnë të ndërtojnë njeriun e të patëmetë, duke ia hequr si me dorë shpirtin? “Portokall me kurdisje” është ironi e drejtpërdrejtë ndaj ideologjisë që kërkon të prodhojë qytetarë të mirë përmes kontrollit totalitar, qoftë me drogë, qoftë me terapi. Teknika Ludovik është mënyra konkrete se si një portokall kthehet në makineri. Aleks është më njeri kur nuk ndien më urrejtje, por as kur nuk e dëgjon dot më Bethovenin për shkak të nakatisë. Në një rrafsh më të gjerë kulturor, titulli shpalos edhe dehumanizimin e njeriut në epokën moderne, ku përballet me presionin për të qenë “i përshtatshëm”, “i përmirësuar”, “model”. Bërzhësi shkon përtej fabulës së vet dhe përbalt të gjitha format e kontrollit social, të cilat e shesin mirësinë si produkt, nisur që nga mediet, politika, apo shkenca që s’e kuptoi kurrë shpirtin njerëzor. Portokall me kurdisje mund të jetë çdo njeri që është shtrydhur nga vullneti i vet, për t’iu përshtatur një norme të caktuar. Ai është simbol i



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Ofendoi rivalët, dënohet Taulant Xhaka

Taulant Xhaka është suspenduar për një ndeshje nga liga zvicerane e futbollit. Dënimi që iu dha të premten nënkupton se Xhaka do të

jetë pjesë e Baselit në ndeshjen përshëndetëse ndaj Luzernit javën e ardhshme. Mesfushori me përvojë është dënuar pasi bëri fyerje ndaj

Zurichut dhe Grasshopperit në festën e Baselit pasi u siguria titulli i kampionit të Zvicrës. Xhaka është gjobitur me 7 500 euro dhe duhet të

bëjë “shërbim për komunitetin në të mirë të futbollit”. Xhaka nuk do të jetë pjesë e Baselit në ndeshjen e së

dielës ndaj Young Boysit. Taulant Xhaka i jep fund karrierës në fund të këtij edicioni. Ai nuk po luan fare për Baselin.

Të dielën zhvillohet finalja e pestë

PRIZREN, 16 MAJ - Super finalët e “play-off”-it të ProCredit Superligës vazhdojnë sfidën e pestë, që zhvillohet të dielën në Palestrën “Sezai Surroi” në Prizren. Bashkimi dhe Trepça ndeshen sërish në një betejë, ku të dy skuadrat do të luftojnë deri në fund për fitore. Mitrovicasit po fitojnë në serinë finale 3:1 dhe janë një hap afër ta mbrojnë titullin e kampionit. Ndërkohë, prizrenasit duan fitore para tifozëve të tyre në shtëpi, për të mbetur në garë për titullin e kampionit. Skuadra që shënon katër fitore shpallet kampione e Kosovës. Trepça është një hap afër trofeut më të rëndësishëm të basketbollit në Kosovë, ndërsa Bashkimi duhet t’i fitojë tri ndeshje për t’u stolitur me titullin e kampionit. Hera e parë dhe e fundit për prizrenasit që fituan titullin ishte më 2018. Portokallezinjtë fituan ndeshjen e parë 84:77, e më pas fituan ‘Xehetarët’, tri ndeshje radhazi, 79:72, 71:88 dhe 80:74. Sfida pritët të



jetë shumë interesante dhe me super spektakël, ashtu siç kanë qenë përballjet mes tyre në finale. Takimi

zhvillohet nga ora 19:00 dhe transmetohet në Art Motion/Kujtesa.

Sot zhvillohet xhiroja e parafundit në Superligë

PRISHTINË, 15 MAJ - Xhiroja e 35-të në Superligën e Kosovës në futboll do të zhvillohet sot (e shtunë) në kohë të njëjtë (16:00). Kjo është xhiroja e parafundit, ndërsa Drita tashmë e ka siguruar titullin e kampiones, derisa vazhdon garat për daljen në garat evropiane dhe mbijetesë. Vëmendja do të jetë në derbin e skuadrave nga qyteti i Gjilanit, Gjilanit dhe Dritës, ndërsa drejtësinë në këtë sfidë e ndan Genc Nuza. Ndeshje interesante do të zhvillohet edhe në Suharekë, ku Ballkani e pret Llapin që kërkon tri pikë për të mos rrezikuar mbetjen në barazh. Ndeshje interesante do të jetë edhe ajo në mes të Malishevës dhe Suharekës, e cila zhvillohet në stadiumin “Liman Gegaj”. Vendësit kërkojnë pikë për ta ruajtur pozitën e tretë, kurse suharekasit do t’i kërkojnë pikët me shpresë për të ikur nga zona e barazhit. Dukagjini e pret Ferizajn në një ndeshje që nuk kanë rëndësi të



madhe pikët, kurse Feronikeli ’74, që tashmë ka rënë nga elita, e pret Prishtinën. Kryeqytetasit do të tentojnë

t’i marrin tri pikët e plota në mënyrë që të largohen edhe me shumë nga pozita e poshtme e renditjes tabelore.

SHKURT

Hadërgjonaj pritët t’i bashkohet Kocaelisporit

Florent Hadërgjonaj, që aktualisht është futbollist i Alanyasporit, pritët që në edicionin e ardhshëm të luajë për Kocaelisporin. Ky ekip do të garojë sërish në elitën e futbollit të Turqisë pas 16 vjetësh, pasi ka siguruar promovimin në Superligë nga vendi i parë me 72 pikë. Hadërgjonaj në edicionin aktual për Alanyasporin ka luajtur në 34 ndeshje, ndërsa ka kontribuar me pesë gola e po aq asistime. Mbrojtësi i krahut të djathtë që përfaqëson Kosovën pëlqehet shumë nga drejtuesi e skuadrës së Kocaelisporit. Tel Alanyaspori me Hadërgjonajn luan edhe mbrojtësi tjetër i Kosovës, Fidan Aliti.

Mitrovica dhe Dukagjini, në finale të Kupës së Kosovës në konkurrencën e femrave

Janë zhvilluar ndeshjet e kthimit gjysmëfinale në kuadër të Kupës së Kosovës në konkurrencën e femrave, ku janë përcaktuar edhe dy skuadrat finaliste të edicionit 2024/25. Mitrovica dhe Dukagjini janë ekipet që do të përballen në finalen e madhe të kësaj gare. Të dyja skuadrat arritën fitore edhe në ndeshjet e kthimit ndaj kundërshtarëve të tyre. Mitrovica shënoi fitore minimale ndaj Malishevës me rezultat 1:0 falë golit të shënuar nga Emërllahu, derisa në sfidën e parë kishte fituar 2:1. Ndërkohë, Dukagjini konfirmoi epërsinë ndaj Prishtinës, duke triumfuar me rezultat 2:1, pas fitores 2:0 në ndeshjen e parë. Golat për skuadrën nga Klina u shënuan nga Pjetri dhe Berishaj. Finalja e Kupës së Kosovës në konkurrencën e vajzave do të zhvillohet më 19 maj, në orën 17:00, në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë.

Kastrioti kualifikohet në finale të plejofit

Në praninë e më shumë se 2000 shikuesve, në palestrën “Bill Clinton” në Ferizaj u zhvillua ndeshja e tretë gjysmëfinale e

plejofit në Superligën e Kosovës në hendboll në konkurrencë të meshkujve. Pas një ndeshje të fortë dhe interesante, fitore

shënoi Kastrioti. Skuadra ferizajase e mposhti Besa Famgasin me rezultatin 31:27 dhe bëri vend në finale të

plejofit. Ndeshja e parë finale, Rahoveci – Kastrioti, zhvillohet të dielën mbrëma në palestrën “Mizahir Isma” në Rahovec.

Kastrioti e fitoi Kupën këtë edicion garues dhe tani do të takohet me Rahovecin në garën finale për titull të kampionit.

Flick: Kurrë më parë nuk jam ndier kështu

Barcelonë, 16 maj - Trajneri i Barcelonës, Hansi Flick, ka zbuluar ndjenjat e tij pas triumfit në La Liga për edicionin 2024/25. Barcelona fitoi ndaj Espanyolit me rezultat 0-2, duke fituar titullin për këtë edicion, kur kanë mbetur edhe dy ndeshje për t'u luajtur. "Ndihe mi vërtet si

një familje e vërtetë. Ata më ndihmuan të jem i lumtur dhe të punoj me këtë pasion. Kurrë më parë nuk jam ndier kështu", ka thënë fillimisht Flick në konferencën e parë për shtyp si kampion i La Ligës. Flick vazhdoi ta përshkruante pikën kulmore të sezonit me

një fjali të vetme. "Vendimi më i vështirë i këtij sezoni ishte vendimi për portierin", ka deklaruar gjermani. "Ndeshjet kundër Real Madridit kanë qenë më të mirat e sezonit. Momenti më emocional gjatë këtij sezoni ishte humbja e Dr. Minarro. Ne nuk e kemi harruar atë. Ai do të ketë

gjithmonë një vend në zemrat tona". "Tani mund të kënaqem. Gjatë ndeshjeve jam gjithmonë nën stres. Tani do të jem i qetë", ka përfunduar Flick. Ajo që Flick arriti me Barcelonën këtë sezon është vërtet e jashtëzakonshme. Në fillim të sezonit askush nuk i



dha Barcelonës një shans pasi Xavi u shkarkua dhe u soll vetëm një lojtar me shumë para.

Ronaldo, sportisti më i paguar për të tretin vit radhazi

Riyadh, 16 maj - Cristiano Ronaldo ka kryesuar listën e revistës "Forbes" për sportistët më të paguar në botë për të tretin vit radhazi, ndërsa ylli i NBA-s, Stephen Curry, është ngjitur në vendin e dytë. Sipas revistës së njohur të biznesit, Ronaldo, i cili e ka kryesuar këtë listë pesë herë gjatë karrierës, ka rritur të ardhurat e përgjithshme të vlerësuara me 15 milionë dollarë, duke arritur në 275 milionë dollarë. Kjo shifër është tejkaluar vetëm nga boksieri i njohur Floyd Mayweather, i cili fitoi 300 milionë dollarë në vitin 2015 dhe 275 milionë dollarë në vitin 2018. Sulmuesi portugez, 40-vjeçar, u transferua në ligën saudite të futbollit me skuadrën Al Nassr në dhjetor 2022 dhe ka rritur të ardhurat e tij përmes marrëveshjeve të sponsorizimit dhe mbështetjes nga rrjetet sociale, ku aktualisht ka 939 milionë ndjekës. Ylli i Golden State Warriors, Stephen Curry, i cili në mars u bë lojtari i parë në NBA që arrin 4 000 pikë në karrierë, është ngjitur në vendin e dytë me 156 milionë dollarë. Boksieri britanik Tyson Fury është ngjitur në



vendin e tretë me 146 milionë dollarë, pavarësisht se humbi titujt botërorë në peshën e rëndë ndaj ukrainasit Oleksandr Usyk në dhjetor. Fury përfitoi financiarisht nga një "reality show" në Netflix

dhe një marrëveshje me turizmin maltez. Rivali i përjetshëm i Ronaldos, Lionel Messi, ka rënë më poshtë në renditje, duke kaluar nga vendi i tretë në të pestin.

10 SPORTISTËT MË TË PAGUAR NË BOTË PËR VITIN 2025

1. Cristiano Ronaldo, futboll - 275 milionë
2. Stephen Curry, basketboll - 156 milionë
3. Tyson Fury, boks - 146 milionë
4. Dak Prescott, futboll amerikan - 137 milionë
5. Lionel Messi, futboll - 135 milionë
6. LeBron James, basketboll - 133.8 milionë
7. Juan Soto, bejsboll - 114 milionë
8. Karim Benzema, futboll - 104 milionë
9. Shohei Ohtani, bejsboll - 102.5 milionë
10. Kevin Durant, basketboll - 101.4 milionë

Hamiltoni: Nuk erdha te Ferrari për të garuar për vendet 7-8

MARANELLO, 16 MAJ - Sezoni 2025 në Formula 1 nuk ka qenë aspak pozitiv për pilotin britanik Lewis Hamilton. Ai erdhi te Ferrari me pritshmëri të mëdha, por vetëm triumfi në garën sprint të Kinës është shumë pak për shtatë herë kampionin e botës. "Nga ky moment e deri në garën e Montmelo do të përpqemi t'i zhblllokojmë disa performanca që nuk kemi qenë në gjendje t'i shfrytëzojmë. Po ndjekim planin tonë. Shpresojmë të marrim më shumë sesa bëmë në garën e fundit", ka thënë Hamiltoni. "Në Spanjë do të duhet të vendosin një krah të përpamë të ndryshëm. Do të jetë interesante



të shohim se si do të ndikojë në pistë. Makina ende ka shumë performancë që nuk kemi mundur ta zhblllokojmë. Nuk mund t'ia mbyllim derën asnjë ideje. Duhet t'i mbajmë sytë hapur dhe kokën lart. Duhet të vazhdojmë t'i shtyjmë pritjet dhe

qëllimin e fitores. Ky është qëllimi çdo fundjavë. Kur jam ulur këtu me inxhinierët, e pyes veten se si do ta fitojmë këtë fundjavë", ka shtuar Hamiltoni. "Ndoshta jam paksa shumë i sigurt, por kështu duhet t'i qasemi çdo gare. Duhet të vish pozitiv dhe agresiv. Nuk do të hyj në këtë fundjavë duke menduar se do të jemi të shtatit ose të tetit. Dhe do ta ndryshoj këtë mentalitet. Është e vërtetë se McLaren është më shumë se 100 pikë para nesh, por sezoni është ende i gjatë. Gjërat mund të ndryshojnë dhe risitë që do të vijnë gradualisht kanë pikërisht këtë qëllim", ka deklaruar Hamiltoni.

SHKURT

Denveri mudi Oklahomën, finalist i dytë përcaktohet në sfidën e shtatë

Ndërsa Minnesota pret ta mësojë emrin e skuadrës rivale për titullin kampion në Konferencën e Perëndimit, ajo do të dalë pas ndeshjes së shtatë mes Denverit dhe Oklahomas. Në sfidën e gjashtë gjysmëfinale, ekipi i Denver Nuggetsit fitoi 119-107 ndaj Oklahoma City Thunderit, skuadrës me rekordin më të mirë në sezonin e rregullt. Tashmë seria është barazuar në shifrat 3-3. Një ndeshje me rivalitet, ashtu sikurse kanë qenë edhe të tjera. Për Denverin u dallua Jokiqi me 29 pikë e 14 kërcime, mbështetur nga Murray me 25 pikë e Browni me 23 pikë. Për Thunderin, Alexander Shai realizoi 32 pikë, por që s'mjaftuan.

Alba vazhdon kontratën me Inter Miamin

Të reja të rëndësishme tek Inter Miami. Klubi i MLS ka zyrtarizuar rinovimin me mbrojtësin Jordi Alba. Alba do të qëndrojë te kjo skuadër, të paktën deri në vitin 2027. "Jam shumë i lumtur që rinovova kontratën. Kam ende dëshirë të garoj dhe ndihem mirë te ky klub. E ndiej dashurinë e tifozëve në çdo ndeshje dhe këto dy vjet kanë qenë fantastike për mua. Dua të vazhdoj të fitoj dhe ta ndihmoj ekipin të arrijë sa më shumë trofe", ka deklaruar Alba.

Muller: Nuk e di të ardhmen

Fituesi i Kupës së Botës, dy herë fitues i tripletës, krijues i paraqitjeve rekord, Thomas Muller dhe FC Bayern Munich vendosën së bashku t'i japin fund këtë verë një karriere unike që përfshin 25 vjet dhe 33 trofe. Mulleri ka folur së fundmi sa i takon së ardhmes. "Nuk e di ende ç'do të bëhet me të ardhmen. Në këto momente s'kam asgjë konkrete. Besoj se javët në vazhdim do të jenë mjaft interesante. Botërori për Klube do të jetë një përvojë intriguese dhe them se do të përfitoj për të parë se çfarë bëhet atje", ka deklaruar Muller.

Kumbulla: Rikthehem në Romë, pastaj të shohim

Mbrojtësi i Romës, Marash Kumbulla, aktualisht i huazuar te Espanyoli, ka folur për të ardhmen e tij në një intervistë për "Gazzetta.it", ku ka lënë të hapur gjithçka për sezonin e ardhshëm. "E vetmja gjë e sigurt është se do të rikthehem në kryeqytet. Pastaj do të shohim, sepse për momentin nuk ka as trajner në detyrë" u shpreh Kumbulla, duke nënvizuar se e ardhmja e tij do të varet nga projektet që do të ketë Roma në verë. Mbrojtësi shqiptar theksoi se ka një marrëdhënie shumë të mirë me klubin dhe me drejtuesit: "Federico Balzaretti më telefonon gjithmonë, madje ka ardhur edhe këtu për të më parë. Marrëdhënia me klubin është shumë e mirë". Kumbulla, i cili gjatë këtij sezoni ka gjetur më shumë hapësira dhe formë te Espanyoli, theksoi se më e rëndësishmja për të është që ka rikuperuar fizikisht dhe po luan rregullisht: "Për momentin nuk mendoj shumë për të ardhmen. E rëndësishme është që kam gjetur vazhdimësi, jam mirë fizikisht dhe kam luajtur shumë". Rikthimi në Romë është i sigurt, por e ardhmja e Kumbullës pritet të qartësohet pas vendimeve që do të marrë klubi për trajnerin e ri dhe projektin sportiv për sezonin 2024/2025.

Botërori i Klubeve, Bellingham: Një mundësi historike për Realin

Jude Bellingham ka shprehur entuziazmin e tij për Botërorin e Klubeve 2025, që do të zhvillohet në ShBA dhe ku Real Madridi do të marrë pjesë me synimin për ta fituar për herë të parë në këtë format të ri:

"Jemi përpara një mundësie për të fituar një titull ndryshe, një titull të vërtetë. Të bëhemi klubi i parë që e fiton në këtë format është diçka e rëndësishme. Ky është Real Madridi, një klub që meriton të

jetë në këtë lloj skene". Për mesfushorin anglez, Botërori i Klubeve ka një domethënie të veçantë. Do të jetë përvojë e bukur për të gjithë: "Shumë ekipe nuk kanë mundësinë të luajnë rregullisht në skena kaq

të mëdha dhe tani do të përballen me klubet më të mira të Evropës. Kjo është fantastike për ta dhe për ne". Bellinghami pranon se ka shumë pikëpyetje për formatin dhe rëndësinë e Botërorit të Klubeve, por

nënvizon: "Për ne është një tjetër titull për t'u fituar. Nuk e marrim lehtë. Është diçka historike, sepse në këtë klub nuk kanë mbetur shumë gjëra për t'u bërë, që nuk janë arritur tashmë".



Prishtinë, 05.05. 2025

NJOFTIM PUBLIK

Shoqëria „SVB ENERGY“ SH.P.K., me numër Unik Identifikues 812074532 me adresë: Rr. „20 Qershori“ pn, Komuna e Istogut Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 13 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, me datë 13.01.2025 ka dorëzuar në Zyren e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit dhe për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelët solare me kapacitet të instaluar prej **3 MW** ZK Sinajë, Komuna e Istogut, Republika e Kosovës.

Shoqëria „SVB ENERGY“ SH.P.K., për projektin solar me kapacitet të instaluar prej 3 MW ZK Sinajë, Komuna e Istogut, me rastin e aplikimit, ka dorëzuar në ZRRE dëshmitë për marrje të AUTORIZIMIT sic janë:

- Pëlqimin Mjedisor Nr.2763-2/24 dt. 30.05.2024 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Pëlqimin nr. 11-351-241-23 dt. 22.11.2023 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis e Komunës së Istogut.
- Vendimin për Leje Ndërtimore Numri i Lëndës: Nr. 11-351-25250/111 të datës 15.10.2024 për “Ndërtimin e Parkut të Energjisë Solare Fotovoltaik me kapacitet prej 3 MW, ZK Sinajë, të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis e Komunës së Istogut.
- Pëlqimin Elektroenergetik Nr. 19361 dt. 20.12.2024 të lëshuar nga KEDS SH.A.
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratat për shfrytëzimin e tokës);
- Deklaratën për shitjen e energjisë;
- Deklarimet financiare;
- Dëshmi për posedimin e 10% të vlerës së investimit
- Kontratën për Inxhinieri, Prokurim dhe ndërtim (EPC)
- Studimi i fizibilitetit teknik dhe financiar,
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.

Aplikuesi ka dorëzuar edhe kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ka dorëzuar deklaratën që, energjia e prodhuar nga ky projekt do të shitet bazuar në çmimet e tregut.

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi në adresën elektronike: skender.rugova@hotmail.com, arber.lubishtani@elen-ks.com dhe LEGAL-LENCING@ero-ks.org

Qasja në dosjen e Aplikimit, për të cilat Aplikuesi ka lejuar qasje, mundësohet për atë që e lejon legjislacioni për Qasje në Dokumentet Publike.

Gjeji PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeji Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISTINE

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Florentina Shehadadi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.
- Xhelal Halilosmani shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të nga klasa 1-8 të shkollës SH.F.M.U "Mazllum Këpuska".
- Ali S. Gashi B.I. N.T.P "Liria Te Lulja" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr Unik Identifikues: 811258559.
- Liridona Qarri shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Profesionale "Gjon Nikoll Kazazi" Gjakovë.
- Mentor Podrimja B.I. shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues: 811137034.
- Vilhard Uka shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. "Dëshmorët Lleshi" Doblibare Gjakovë nga kl.1-8.
- Valbone Kodra shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 diplomën dhe certifikatën e maturës shtetërore sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Sabina Nrecaj shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shf.m.u "Anton Qeta" Dol Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- 3B Skele VEB SH.P.K. Gjakovë shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues 812242824 të lëshuar nga ARBK.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, salloni dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

